



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.02.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit për datat 30 janar dhe 4 shkurt 2019.
2. Miratimi i draftkalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 11 shkurt – 1 mars 2019.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e Protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut”.
4. Projektvendim “Për miratimin a kandidaturave për pozicionet e Komisionerëve pranë Avokatit të Popullit”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Damian Gjicknuri, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Silva Caka dhe Fatmir Mediu.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Nasip Naço dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Petrit Çuni - Drejtor i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së
Gjergji Methoxha - Drejtor i Drejtorisë së Politikave të NATO-s dhe BE-së në Ministrinë e Mbrojtjes

Artemis Dralo – Zëvendësministre për Europën dhe Punët e Jashtme

Armand Skapi - Drejtor i Drejtorisë së Traktateve

Ilir Melo - Drejtor i Rajonit dhe Vendeve Fqinje

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Vazhdojmë me rendin e ditës. Kemi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të zhvilluara në datat 30 Janar dhe 4 shkurt 2019.

A jeni dakord me procesverbalet? Dakord.

Miratohen procesverbalet.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, miratimi i draftkalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 11 shkurt – 1 mars 2019. Kalendari është mbi tryezat e kolegëve.

A ka vërejtje për kalendarin? Nuk ka.

Miratohet draftkalendarit i punimeve të komisionit për periudhën 11 shkurt – 1 mars 2019. *(Mungesë incizimi)*

...për vendin tonë fqinj republikën më të re Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kush do të bëjë një prezantim, zonja Dralo? Do të bëni një prezantim të këtij projektligji për kolegët e komisionit? Më pas do t'ia kaloj fjalën relatorit të këtij projektligji zotit Fino.

Artemis Dralo - Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Projektligji ka për qëllim ratifikimin e Protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili është nënshkruar në shkurt të po këtij viti në Bruksel. Paraqitja në parlament e këtij protokollit për ratifikim vjen në zbatim të nenit 17 të ligjit nr.43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë”. Traktati i Atlantikut të Veriut parashikon në mënyrë të qartë se vendimi për anëtarësimin e shteteve të reja merret në unanimitet nga ana e shteteve anëtare.

Ftesa që iu akordua nga NATO-ja Republikës së Maqedonisë së Veriut ka ardhur si një vlerësim për vullnetin e vazhdueshëm politik të këtij vendi për t'u anëtarësuar në NATO, për reformat e ndërmarra nga ky vend, për përpjekjet në përballimin e sfidave të sigurisë, si edhe për angazhimin për të përfunduar marrëveshjen historike me shtetin grek lidhur me emrin.

Më lejoni të nënvizoj rolin konstruktiv dhe mbështetës që faktori shqiptar në Maqedoninë e Veriut i ka dhënë procesit të anëtarësimit të këtij vendi në NATO.

Rotacioni politik në vendin fqinj, kryesisht arritja e marrëveshjes së Prespës për çështjen e emrit me Greqinë, i nxitën vendet anëtare të NATO-s në takimin e krerëve të shteteve dhe të qeverive të vendeve anëtare të kësaj aleance, që është mbajtur në 11-12 korrik të vitit 2018 që t'i akordojë Republikës së Maqedonisë së Veriut ftesën për t'u

anëtarësuar në NATO. Ratifikimi i protokollit të anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO në aspektin politik është në zbatim të plotë të politikës së NATO-s, të programit të dyerve të hapura që përbën një shembull të qartë të parimit politik, demokratik se çdo shtet sovran ka të drejtën e pakundërshtueshme për të zgjedhur në mënyrë të lirë aleancat e saj.

Republika e Maqedonisë së Veriut ka bërë një rrugë relativisht të gjatë drejt anëtarësimit në NATO. Përpjekjet institucionale të kësaj republike për të arritur anëtarësimin në NATO kanë filluar që me anëtarësimin në nismën e partneritetit për paqe në vitin 1995. Në atë kohë ish-Maqedonia u pranua në Këshillin e Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut, i cili u pasua më pas në vitin 1997 nga Këshilli i Partneritetit Euroatlantik. Një vit më parë në vitin 1996 në Shkup është hapur zyra për ndërlidhjen e NATO-s dhe në fund të vitit 1997 u hap në Selinë e NATO-s misioni i përhershëm i Maqedonisë.

Në prill të vitit 1999 në Samitin e NATO-s në Uashington ish -Republikës Jugosllave e Maqedonisë i është dhënë statusi i vendit kandidat për anëtarësim. Që nga ajo kohë filloi pjesëmarrja e vendit në planin e veprimit për anëtarësim. Republika e Maqedonisë së Veriut është vlerësuar pozitivisht nga vendet aleate për pjesëmarrjen e saj në misione ndërkombëtare të paqeruajtjes, duke filluar që nga viti 2002 me misionin e INSAF-it në Afganistan, si dhe në vitin 2006 me misionin e BE-së ALTHEA në Bosnje dhe Hercegovinë.

Për sa i përket rrafshit të sigurisë ky anëtarësim ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë në hapësirën euroatlantike, si dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO redukton më tej influencën e fuqive të treta në rajonin tonë, si dhe ndikon ndjeshëm në forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë.

Siç e kanë bërë të qartë vendet anëtare të NATO-s procesi i reformave në Republikën e Maqedonisë së Veriut duhet të vazhdojë jo vetëm gjatë periudhës së anëtarësimit, por sigurisht edhe më pas. Ky është një proces në vazhdimësi, i cili synon bërjen shtet anëtar i NATO-s me aftësi të plota të këtij shteti. Vendet aleate kanë bërë të ditur se dëshirojnë të shikojnë përparim në reformat në sektorin e inteligjencës dhe të sigurisë, sundimit të shtetit ligjor, pavarësisë së gjyqësorit, si edhe aftësive mbrojtëse të vendit.

Me hyrjen në fuqi të këtij protokollit nga të gjitha vendet anëtare sekretari i Përgjithshëm i NATO-s i komunikon qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ftesën

për t'u pranuar në traktatin e Atlantikut të Veriut. Në përputhje me nenin 10 të këtij traktati Republika e Maqedonisë së Veriut bëhet palë në të vetëm atëherë kur deponon instrumentin e anëtarësimit në qeverinë e SHBA-ve, të cilët janë edhe deponuesit e këtij traktati. Protokollin hyn në fuqi kur secila nga palët e traktatit të Atlantikut të Veriut të ketë njoftuar për vendimin e marrë qeverinë e SHBA-ve.

Për Republikën e Shqipërisë kjo procedurë do të ndiqet pas hyrjes në fuqi të ligjit për ratifikimin e këtij protokollit.

Të nderuar deputetë, nëpërmjet këtij ratifikimi Republika e Shqipërisë bëhet ndër vendet e para të aleancës, e cila shprehet pozitivisht për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit!

Nga Ministria e Mbrojtjes? Apo jemi mjaftueshëm me prezantimin e zëvendësministres për Europën dhe Punët e Jashtme?

Fjalën e ka kolegu Fino si relator i këtij projektligji.

Bashkim Fino - Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj drejtuesit që kanë ardhur sot, përfaqësuesit e qeverisë të Ministrisë së Jashtme dhe Ministrisë së Mbrojtjes për të kaluar një projektligj shumë të rëndësishëm, i cili ditën e enjte fillon me ratifikimin e Protokollit të Traktatit të Atlantikut të Veriut për Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ky projektligj është nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 81 dhe 121 të Kushtetutës, si edhe në nenin 17 të ligjit nr.43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë".

Projektligji, siç tha edhe zëvendësministrja synon ratifikimin e Protokollit të Traktatit të Atlantikut të Veriut për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO.

Nuk dua të zgjatem shumë, sepse qeveritë e Greqisë dhe të Maqedonisë duke qenë vende, shtete fqinje të përfaqësuara nga kryeministrat Cipras dhe Zaev kanë rënë dakord në Marrëveshjen e Prespës të datës 17 qershor të vitit 2018 për të pranuar më së fundi emrin Maqedonia e Veriut. Marrëveshja e Prespës i dha fund këtij konflikti të gjatë diplomatik prej më shumë se dy dekadash midis Athinës dhe Shkupit.

Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje vendet anëtare të NATO-s vendosën takimin e krerëve të shteteve të qeverive të vendeve anëtare të aleancës më 11-12 korrik të

vitit 2018 t'i akordojnë zyrtarisht Republikës së Maqedonisë së Veriut ftesën për t'u anëtarësuar në NATO.

Me ratifikimin e marrëveshjes së Prespës zyra ligjore e sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s hartoi protokollin e anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO, i cili u është shpërndarë vendeve anëtare të NATO-s për ndjekjen e procedurave përpara nënshkrimit.

Protokolli për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO u nënshkrua më 6 shkurt të vitit 2019 nga të plotfuqishmit e 29 vendeve anëtare të NATO-s. Pritet dhe ratifikimi në parlamentet e këtyre vendeve, si edhe në parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Siç e dini edhe nga lajmet, Greqia e ka ratifikuar një marrëveshje të tillë. Sot e ratifikon Bullgaria. Ne kemi fatin si vend fqinj t'i japim ndihmën konkrete të menjëhershme Maqedonisë së Veriut që të ratifikojmë edhe ne këtë marrëveshje ditën e enjte në seancë plenare në mënyrë tepër solemne.

Me ratifikimin e protokollit në mënyrë unanime nga të gjitha vendet, mund të çojë që Maqedonia e Veriut të bëhet anëtari i 30 i NATO-s.

Të dashur kolegë, në aspektin ligjor vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi. Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Duke qenë një vendim tejet i rëndësishëm për të gjithë parlamentin shqiptar, për të 140 deputetët vlerësoj si relator se duhet ta miratojmë projektligjin.

Ju kërkoj kolegëve ta miratojmë në këtë komision dhe të shkojmë me unanimitet të plotë në ratifikimin e marrëveshjes së Maqedonisë së Veriut për t'u anëtarësuar në NATO.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ka pyetje nga kolegët? Nuk ka.

Kalojmë në diskutime. E ka kërkuar fjalën zoti Mediu.

Fatmir Mediu- Faleminderit, zoti kryetar!

Që në fillim të fjalës, jo vetëm dua të jap mbështetjen time si deputet i Kuvendit dhe forcës politike që përfaqësoj apo opozitës, por mendoj se në mënyrë të padiskutueshme për rëndësinë që mbart ky akt parlamenti duhet të ratifikojë në mënyrë unanime këtë projektligj, për vetë rëndësinë që ai mbart.

Anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në NATO është një hap i rëndësishëm edhe për Shqipërinë nga pikëpamja e sigurisë, e zgjerimit të NATO-s në Ballkan, duke shpresuar që i gjithë Ballkani në të ardhmen të jetë pjesë e NATO-s. Por gjithashtu është pjesë e një

përpjekje të jashtëzakonshme të Maqedonisë së Veriut për t'u bërë anëtare e NATO-s me të drejta të plota dhe një angazhimi të përbashkët edhe me Shqipërinë ndër vite si nga pikëpamja ushtarake, edhe nga ajo diplomatike, një angazhim i cili ka filluar në mënyrë të përbashkët me miratimin e Adriatik 3-shit, angazhime të përbashkëta gjatë gjithë kohës e deri në marrjen e ftesës për anëtarësimin e plotë, ku Shqipëria dhe Kroacia si vende të Adriatik 3-shit morën ftesën për anëtarësim për vitin 2008, u anëtarësuan në vitin 2009 dhe për shkak të mosmarrëveshjeve apo problemeve që kishte me Greqinë në atë kohë, Maqedonia edhe pse e meritonte të ishte vend anëtare e NATO-s për fat të keq nuk e mori ftesën për anëtarësim për shkak të kundërshtisë së Greqisë.

Ratifikimi i marrëveshjes së Prespës, unë besoj se është një element tjetër shumë i rëndësishëm dhe sinjal pozitiv në rajonin e Ballkanit kur dy vende, të cilat kanë kundërshti me një mbështetje pothuajse me të njëjtin qëndrim të Europës dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës arritën të kapërcejnë mosmarrëveshjet dhe të bien dakord për çështjen e emrit, por edhe për marrëdhënie të tjera të cilat janë të rëndësishme nga pikëpamja e fqinjësisë së mirë dhe të një marrëdhënie brenda Aleancës së Veriut.

Shpresoj dhe besoj se ky është edhe një moment reflektimi në raport me çështje të tjera, të cilat janë ende të pazgjidhura në Ballkan, që krijojnë probleme në konceptin e sigurisë për të gjithë rajonin, siç është çështja e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, një zgjidhje, e cila duhet të synojë pa dyshim jo vetëm njohjen e statusit të Kosovës, jo vetëm integritetin territorial të saj, por një marrëdhënie të qëndrueshme afatgjatë në Ballkan.

Zëvendësministrja e përmendi faktin e prezencës së aktorëve të tretë, mendoj se nga ana e Ministrisë së Jashtme ka ardhur koha të flasim hapur dhe qartë se cilët janë faktorët e tretë në Ballkan, të cilët përpiqen të ndikojnë në sigurinë e Ballkanit, faktorë të cilët në mënyrë të padiskutueshme tashmë janë kundër zgjerimit të NATO-s në Ballkan, por edhe kundër zgjerimit të BE-së drejt Ballkanit.

Rusia tashmë ka një prezencë ushtarake, inteligjence ekonomike, mediatike, po përpiqet të ndryshojë edhe narativën për sa u përket marrëdhënieve me Ballkanin, tentoi të krijojë një hapësirë veprimi dhe marrëdhënie sa më të gjerë në rajonin e Ballkanit me synime të qarta që lidhen me strategjinë e sigurisë së tyre dhe me influencën që duan të kenë në rajonin e Ballkanit. Në këto momente, mendoj se kur ratifikojmë marrëveshje të tilla, do të ishte shumë e rëndësishme që këtë aspekt ta analizojmë në mënyrë më të qartë si deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, pavarësisht se ne jemi Komisioni i Ligjeve, por na takon si ligjvënës të informohemi pak më drejt nga Ministria e Jashtme pikërisht për këto ndërhyrje dhe të

marrim një qëndrim më të përcaktuar politikisht si forca politike, për sa kohë këto ndërhyrje bien ndesh edhe me interesat tona kombëtare, edhe me interesat e sigurisë kombëtare.

Pa dashur të zgjatem, e quaj një moment jashtëzakonisht të rëndësishëm që Shqipëria të jetë ndër vendet e para të ratifikimit të këtij protokollit dhe njëkohësisht të ketë një votim unanim. Si përfaqësues i opozitës, besoj edhe kolegët e tjerë të mi të opozitës kanë një qëndrim dhe do të shkojmë për ta votuar dhe për ta mbështetur deri në fund siç kemi bërë gjatë punës sonë kur kemi qenë në qeverisje anëtarësimin e plotë të Maqedonisë së Veriut në Aleancën e Atlantikut të Veriut.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar zonja Caka. Pastaj fjalën e ka zoti Strazimiri.

Silva Caka - Faleminderit, zoti kryetar!

Pa dashur të shtoj shumë nga çfarë tha relatori dhe kolegu parafolës thjesht dua të them 2-3 fjalë shumë shkurt lidhur me ratifikimin e këtij protokollit për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO. Është një lajm jashtëzakonisht i mirë në radhë të parë për fqinjin tonë që arriti pas shumë vitesh të zgjidhte një problem, siç ishte ai i emrit me shtetin tjetër fqinj Greqinë.

Në radhë të dytë për faktin se brenda këtij shteti ekziston një faktor shumë i rëndësishëm gati do të thosha shtetformues që janë shqiptarët e Maqedonisë, është një lajm i mirë edhe për vëllezërit që janë atje dhe sigurisht ajo që është më i rëndësishëm anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në NATO i shërben në mënyrë të padiskutueshme paqes dhe sigurisë në rajon që siç e përmendi edhe kolegu Mediu është vënë deri diku në kërcënim apo edhe në pikëpyetje këto vitet e fundit.

Kam një sugjerim të fundit, meqenëse është këtu zëvendësministrja për Europë dhe Punët e Jashtme, meqenëse ministria po funksionon me zëvendësministra, praktikisht autoriteti është i njëjtë. Kam vetëm një sugjerim për zëvendësministren: të lutem zonjë kur ju të ktheheni në zyrë me gjithë respektin që mund të kem për ju, të shikoni edhe një herë simbolet tona në përfaqësim, qoftë në ambasadën italiane dhe në çdo ambasadë tjetër, sepse këto nuk janë çështje nacionalizmi, të kuptohemi, por janë çështje të një identiteti kombëtar, i cili në asnjë mënyrë dhe sidomos në këto kohë nuk duhet të cenohet.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit!

Zoti Strazimiri.

Gent Strazimiri - Faleminderit!

Në emër të kolegëve të Partisë Demokratike konfirmojmë ratifikimin pa rezerva të Protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për anëtarin më të ri të NATO-s Republikën e Maqedonisë së Veriut. Është vërtet një lajm shumë i mirë për rajonin dhe ne si Republikë e Shqipërisë kemi të gjithë të drejtën të jemi krenarë, sepse jemi shteti i parë që në hapat e parë të demokracisë në Shqipëri kemi njohur pavarësinë e Maqedonisë së Veriut këtu e 20 e ca vjet më parë dhe, që nga ajo ditë, duke mbrojtur integritetin territorial, duke ruajtur parimet e fqinjësisë së mirë, kemi qenë bashkudhëtarë në rrugën drejt integritetit të Maqedonisë dhe të të gjithë rajonit në BE dhe në NATO.

Maqedonia, sigurisht që ka ecur mirë, kurse ne, mjerisht, jo aq mirë sa Maqedonia në ritmet e integritetit. Maqedonia, përveç anëtarësimit në NATO, me shumë mundësi, në qershor do të ketë hapjen e negociatave me BE-në, çka nuk mund ta themi për Shqipërinë.

Populli është në rrugë, shqiptarët po protestojnë kundër kësaj qeverie, pikërisht që Shqipëria, anëtare prej 10 vjetësh e NATO-s, mos ta bëjë veten që ta nxjerrin nga NATO-ja, nga dritarja.

Së bashku me kolegët e mi jam i detyruar ta lë këtë mbledhje dhe të shkoj e të bashkohem me popullin dhe, sigurisht, t'ju kujtoj datën 16 shkurt, ora 11:00, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, për të ruajtur Shqipërinë në NATO, për ta bërë Shqipërinë anëtare të BE-së. Faleminderit!

(Deputetët e PD-së largohen nga komisioni.)

Ulsi Manja - Faleminderit!

A ka diskutime të tjera?

Urdhëroni, zoti Xhafaj!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Bashkohem me të gjithë ata që e konsiderojnë këtë fakt një lajm shumë të mirë, jo thjesht për Maqedoninë, por për rajonin në përgjithësi. Më së paku është miopi politike ta trajtosh këtë çështje sipas pozicioneve partiake.

Anëtarësimi i Maqedonisë në NATO është një çështje në funksion të interesit kombëtar të vendit, pavarësisht partive politike, pavarësisht se ku gjenden partitë politike në maxhorancë apo në opozitë, sepse është e rëndësishme për rajonin, është e rëndësishme për shqiptarët e Maqedonisë një faktor shumë i rëndësishëm shtetformues në këtë vend, por njëkohësisht është e rëndësishme edhe për ne, edhe për interesat tona kombëtare.

Është për t'u vlerësuar dhe duhet ta nënvizojmë rolin pozitiv që ka luajtur qeveria shqiptare në gjithë këtë proces, edhe në zgjidhjen e ngërçit midis Greqisë dhe Maqedonisë, edhe në kompaktësimin e faktorit shqiptar në Maqedoni në funksion të këtij interesi madhor.

Në këtë kontekst, reagimi më i mençur i të gjithëve ishte një votë unanime, pa paragjykime dhe pa këndvështrime partiake.

Faleminderit!

Ulsi Manja – A ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të këtij projektligji.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për ratifikimin e protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikën e Maqedonisë së Veriut”.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim ky projektligj.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me unanimitet projektligji projektligjin “Për ratifikimin e protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikën e Maqedonisë së Veriut”.

Urime, anëtarit më të ri të NATO-s, fqinjit tonë të vjetër me emrin e ri, Republika e Maqedonisë së Veriut!

Urime edhe Shqipërisë që si fqinjë, bëhet ndër vendet e para që ratifikon këtë protokoll kaq të rëndësishëm për Maqedoninë e Veriut!

Zoti Fino, raporti i Komisionit të Ligjeve t'i përcillet komisionit përgjegjës, Komisionit të Sigurisë Kombëtare. Ditën e enjte më një ceremoni solemne kuvendi i Shqipërisë, besoj, me unanimitet do të miratojë këtë protokoll të rëndësishëm, edhe pse opozita sot shprehu dakordësinë në parim, por nuk mori pjesë në votim.

Partia Republikane dhe LSI-ja ishin të pranishme edhe në shqyrtimin në parim, edhe nen për nen.

PR-ja dhe LSI-ja shprehën votën pro dhe ishin të pranishëm në mbledhje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.02.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektvendim “Për miratimin a kandidaturave për pozicionet e Komisionerëve pranë Avokatit të Popullit”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Damian Gjijnuri, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Silva Caka dhe Fatmir Mediu.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Nasip Naço dhe Tom Doshi.

Ulsi Manja - Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës “Projektvendimi për miratimin e kandidaturave për pozicionet e komisionerëve pranë Avokatit të Popullit”.

Komisioni ynë është komision përgjegjës.

Relatore është kolegja Klotilda Bushka.

Në zbatim të nenit 111, pika 7 e Rregullores së Kuvendit, Komisioni i Ligjeve ka administruar dokumentet e kandidatëve për këto pozicione. Sigurisht, është zhvilluar edhe një seancë dëgjimore me kandidaturat e paraqitur për komisioner të Avokatit të Popullit, për të tre pozicionet.

Për pozicionin e komisionerit për seksionin e përgjithshëm janë 4 kandidatura: zonja Vilma Shurdha, zoti Andi Nano, zonja Ermonela Ruspi dhe zonja Eliona Mansaku.

Për pozicionin komisioner në seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor, janë: zoti Arian Hoxha, zonja Ermonela Ruspi, zoti Ilir Kadiu dhe zoti Artan Ballabani.

Për pozicionin komisioner në seksionin për organet e administratës qendrore të pushtetit qendror dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre janë: zonja Elvira Cimb, zoti Andi Nano, zonja Vilma Shurdha dhe zonja Erjona Canaj.

Unë shkurtimisht do t'ia kaloj fjalën relatores për të bërë një prezantim të këtyre kandidaturave për secilin pozicion dhe pastaj dicka për procedurën e votimit.

(Zoti Mediu, shumë faleminderit për prezencën në komision!)

Urdhëroni, zonja Bushka!

Klotilda Bushka - Faleminderit!

Sot marrim në shqyrtim të gjithë informacionin dhe çdo gjë që është shqyrtuar në lidhje me kandidatët, të cilët janë përzgjedhur nga zyra e Avokatit të Popullit për të qenë pjesë e këtij procesi, për sa u takon komisionerëve të këtij institucioni në tre seksione. Pra, është seksioni i përgjithshëm, seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor dhe seksioni për organet e administratës qendrore të pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.

Siç e shpjeguat edhe ju, për secilin pozicion janë paraqitur katër kandidatura dhe disa prej kandidatëve kanë aplikuar në më shumë se një pozicion pune.

Në datën 17 dhjetor është zhvilluar seanca dëgjimore me të gjithë kandidatët, ku anëtarët e Komisionit të Ligjeve kanë qenë të pranishëm, të cilët u kanë bërë pyetje kandidatëve që garojnë për secilin pozicion. Vetëm një kandidat nuk është paraqitur në

dëgjesë dhe është zonja Aliona Mansaku, e cila kandidon për pozicionin komisioner në seksionin e përgjithshëm. Të gjithë kandidatët e tjerë janë dëgjuar dhe kanë marrë pjesë në komision.

Dosjet e dokumentacionit të paraqitur për secilin kandidat janë shqyrtuar nga njësi përkatëse në Kuvend dhe rezultoi që të gjithë kandidatët i plotësojnë kriteret ligjore dhe formale, por vetëm për zonjën Mansaku, e cila nuk u paraqit në dëgjesë, nuk do të bëjmë vlerësim dhe votim.

Në kuadër të procedurës vijuese, në bazë të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, ne duhet të votojmë për secilin kandidat në mënyrë nominale.

Kryetar, nuk ia vlen të përsëris emrat, sepse, kur të kalojmë në procesin e votimit, do t'i themi emrat me radhë, por duhet të kemi parasysh që në seancë plenare duhet të kalojmë për votim të paktën 2 kandidatura, përndryshe procedura kthehet mbrapsht.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Në bazë të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni i Ligjeve do të votojë nominalisht secilën nga kandidaturat. Raporti së bashku me dy kandidaturat që marrin numrin më të madh të votave do t'i përcillen Kuvendit për votim në seancën plenare.

Pa humbur kohë hedhim nominalisht në votim kandidaturat për secilin pozicion. Fillojmë me pozicionin për komisioner për seksionin e përgjithshëm.

Kandidatura e parë është zonja Vilma Shurdha. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet, merr numrin maksimal të votave.

Kandidatura e dytë është zoti Andi Nano. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet

Kandidatura e tretë është zonja Ermonela Ruspi. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Nuk miratohet.

Sipas Rregullores, do ta kalojmë për votim edhe zonjën Aliona Mansaku, edhe pse nuk është paraqitur në seancë dëgjimore.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Nuk miratohet.

Për pozicionin komisioner për seksionin e përgjithshëm do t'i kalojnë për votim Kuvendit dy kandidatura, zonja Vilma Shurdha dhe zoti Andi Nano.

Kalojmë në grupin e dytë të kandidaturave për komisioner në Seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor.

Kandidatura e parë është zoti Arian Hoxha. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Nuk miratohet.

Kalojmë te kandidatura e dytë, zonja Ermonela Ruspi. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kandidatura e tretë, zoti Ilir Kadiu. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kandidatura e katërt, zoti Artan Ballabani. Kush është pro? 1 votë pro. Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Nuk miratohet.

Për seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor do t'i kalojnë për votim Kuvendit, zonja Ermonela Ruspi dhe zoti Ilir Kadiu.

Kalojmë në bllokun e tretë të kandidaturave për komisionerë në seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.

Hedhim në votim kandidaturën e parë, zonja Edlira Cimbi. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kandidatura e dytë, zoti Andi Nano. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Nuk miratohet, pasi është votuar në bllokun e parë të kandidaturave.

Kalojmë te kandidatura e tretë, zonja Vilma Shurdha. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Nuk miratohet, pasi është votuar në bllokun e parë të kandidaturave.

Kalojmë në kandidaturën e katërt, zonja Eriona Canaj. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Edhe për bllokun e tretë të kandidaturave për komisioner në seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre, do t'i kalojnë për votim Kuvendit zonja Edlira Cimbi dhe zonja Eriola Canaj.

Me këtë votim e mbyllim për sot mbledhjen e Komisionit të Ligjeve. Mbledhja e radhës do të jetë nesër, ora dhe rendi i ditës do t'ju njoftohet nëpërmjet postës elektronike nga sekretaria e komisionit.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

